



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT  
MBLEDHJA E GJYQTARËVE**

Nr. 772 Prot.

Tiranë, më 28.06. 2019

**VENDIM**

**“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”**

**Nr. 15, datë 28.06.2019**

Në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 39, pika 3 e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit të Gjykatës Kushtetuese”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

**VENDOSI:**

1. Në nenin 20 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit të Gjykatës Kushtetuese”, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

*1/1. Një çështje mund të përshpejtohet me kërkesën e arsyetuar të një organi kompetent që shqyrton kandidatët për të cilët një nga kriteret e seleksionimit është që të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, ose me kërkesën e arsyetuar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.*

*Trupi gjykues e shqyrton dhe merr vendim mbi këtë kërkesë me propozim të gjyqtarit relator, pasi të ketë njoftuar Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

